

## VEPRA “AREALI GJUHËSOR I ISTOGUT ME RRETHINË”, E AUTORIT DR. SEJDI GASHI, VLERË E RE PËR GJUHËSINË SHQIPTARE<sup>1</sup>

Monografia me titull “Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë”, e autorit Dr. Sejdi Gashi, në plan të parë, është një vazhdimësi e kërkimeve prej dekadash në studimet dialektologjike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), të cilat kanë filluar në vitet '60. Studimet e kësaj natyre kanë filluar shumë më herët edhe në kolonitë e vjetra ndër arbëreshët e Italisë e të Greqisë dhe vazhdojnë të studiohen e rivlerësohen ende me metodat më bashkëkohore shkencore.

Dalja në dritë e veprës së Dr. Sejdi Gashit, “Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë”, zgjeron edhe më tej studimet e dialektologjisë shqiptare. Studimi për të folmen e Istogut vjen pasi autori kishte bërë shumë studime, që kur ishte student dhe më vonë, duke botuar me dhjetëra artikuj nëpër gazeta e revista shkencore, në të cilët janë trajtuar dukuri dialektore për të folmen e kësaj krahine.

Autori Gashi, kërkimet e tij në fushën e dialektologjisë i bashkon sa me ruajtjen e traditës së kërkimeve dialektore në Kosovë, aq edhe me metodat bashkëkohore të traditës së kërkimeve dialektore, duke sjellë analiza dhe përshkrime deskriptive të përmasës fonetike dhe morfologjike, të fjalëformimit, si dhe të strukturës së formimeve sintaksore.

### Struktura e punimit

Monografia e Dr. Sejdi Gashit paraqet një pamje të plotë mbi arealin gjuhësor të Istogut, si një prej të folmeve më periferike të gegërishtes verilindore dhe është konceptuar në tetë njësi tematike: I – *Të dhëna të përgjithshme për Istogun me rrethinë*, II – *Fonetika*, III – *Dukuritë fonetike*, IV – *Morfologjia*, V – *Fjalëformimi*, VI – *Sintaksa*, VII – *Tekste dialektore*, VIII – *Fjalorthi dialektor*, si dhe përfundimet e bibliografia.

1 Studim monografik, botoi: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2018, f. 332.

**Në kreun e parë**, autori shqyrton të dhënat e përgjithshme për Istogun me rrethinë, duke na paraqitur të dhënat historike, ekonomike, politike, arsimore, demografike dhe etimologjike të qytetit të Istogut dhe të dhënat e shumta për 52 fshatrat e komunës së Istogut dhe të dhëna demografike për popullsinë që jeton në ato fshatra. Ai prezanton edhe autorët që janë marrë me studimin e kësaj treve.

## Kreu i dytë – Fonetika

Përqendrohet në veçoritë fonetike dhe fonologjike të së folmes së Istogut me rrethinë, me theks të veçantë edhe në dukuritë fonetike. Ai analizon karakteristikat e kësaj të folmeje në rrafshin fonetik, duke studiuar theksin, sistemin zanor, gjatësinë e zanoreve, nazalizimin dhe denazalizimin, reduktimin e zanoreve, dallimet e kushtëzuara të tyre, diftongjet dhe togjet zanore, sistemin bashkëtingëllor dhe grupet e bashkëtingëlloreve.

## Kreu III – Dukuritë fonetike

Pjesë e këtij studimi janë edhe dukuritë fonetike, si: metafohia, apofonia, kontraksioni, shurdhimi, sonorizimi, asimilimi, disimilimi, metateza, elizioni, aglutinacioni, palatalizimi, reduktimi, kontraksioni i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve dhe analogjia.

Autori Sejdi Gashi, të gjitha këto analiza, i ka bërë pas mbledhjes së materialit në terren, duke përdorur pyetësorin e Atlasit Dialektologjik.

Nga shembujt e dhënë vërehet se studiuesi Gashi, me mjaft sukses, ka bërë analiza të rëndësishme fonetike dhe fonologjike, duke ilustruar çdo përkufizim me shembujt dhe duke cituar literaturë bazë, sipas kriterëve që i kërkon shkencën. Punimit i jep një rëndësi të veçantë edhe përdorimi i një numri të madh metodash shkencore.

Tingujt i studion nga aspekte të ndryshme, duke dhënë shembujt për alternimet e tyre, pra na ofron shumë dukuri fonetike, me shembujt e vrojtuar në terren për karakteristikat arkaike të kësaj të folmeje.

## Kreu IV – Morfologjia

Në këtë fushë, autori Gashi na sjell studime rreth pjesëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës, duke theksuar se ndryshimet morfologjike në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë janë më

të pakta se ato fonetike, ndërkaq edhe ato që ekzistojnë janë të ngjashme me grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Ndër të tjera, analizon emra asnjans prejfoljorë, të tipit: *t'bertitnit, t'iknit* dhe shumësin e emrave mashkullorë me mbaresën –a: *doktorra, profesora*. Përveç 5 rasave të shqipes letrare, këtu përdoret edhe rasia thirrore: *oj, moj, mori*, p.sh. *!O Hysen ol ntu more! se na nxuni nâ<sup>o</sup>tall*. Punimi vijon me mbiemrat, përemrat, sistemin foljor dhe disa trajta foljore të diatezës pësore-vetvetore: *pjéka-póça, njëka-nóça*. Sipas autorit, përdorimi i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës në të folmen e Istogut po bëhet gjithnjë e më shumë i dëndur dhe më i zakonshëm, çka do të thotë se kjo e folme, por edhe të folmet e tjera të shqipes, përditë e më shumë po ndikohen nga shqipja letrare (standarde).

## Kreu V – Fjalëformimi

Në studimin e tij, Sejdi Gashi rëndësi të veçantë i kushton edhe fushës së fjalëformimit. Sipas tij, kjo fushë paraqet interes dialektor, sepse, përmes shqyrtimit dhe analizimit të mënyrave dhe mjeteve fjalëformuese, mund të hetohen më imtësisht shumë aspekte e veçori dialektore të këtij krahu të shqipes. Mënyrat më të shpeshta fjalëformuese në trevën gjuhësore të Istogut janë: Formimi parashtesor-prapashtesor i fjalëve a:t (-atë), a:v (-avë) ävt; Paranyjëzimi: i msúm, i árdhŭn; Kompozimi: shpŕli:g, sýkeç; Përngjitja: mozomokeç (mos+o+Zot+ma+keq); Konversioni: krip, hap, çull.

## Kreu VI – Sintaksa

Nga shembujt e dhënë, vërehet se autori Gashi, me mjaft sukses, ka bërë analiza të rëndësishme sintaksore të së folmes së Istogut, duke ilustruar çdo përkufizim me shembuj dhe duke cituar literaturë bazë, sipas kritereve shkencore, p.sh.: paskajorja del pas foljes gjysmëndihmëse *duhet*, p.sh.: *! Duhet me msu: për me përparu;* – Kur kryefjala shprehet me një emër kolektiv, atëherë edhe kallëzuesi del në numrin shumës, p.sh.: *! Njerzja shóhin se çka po ndo:dh n kŭt vën! etj.*

## Kreu VII – Tekste dialektore

Me anë të teksteve dialektore të vjela drejtpërdrejt nga goja e popullit, autori bën dokumentimin e kësaj të folmeje, duke theksuar se ky material duhet të mblidhet sa më shpejt, sepse po zhduket. Në këtë studim autori

na sjell 20 tekste dialektore në prozë dhe këngë popullore. Sipas studiuësit Gashi, në trojet shqiptare janë të gjitha mundësitë që ky dokumentim gjuhësor të bëhet i plotë, sepse specialistët e mirëfilltë nuk mungojnë.

## Kreu VIII – Fjalorthi

Studiuësi Sejdi Gashi na sjell një thesar të çmuar me fjalë e shprehje të rralla të kësaj ane. Përdoruesi i kësaj idiome gjuhësore është mjaft i pasur dhe përmban një varg dukurish vetjake, të trashëguara nga fazat e hershme të shqipes. Kështu, janë përvijuar një varg njësisish leksikore që shquhen për autoktoninë dhe lashtësinë e tyre, siç janë: *xhakkbâome* (grua me moral të ulët, për shkak të të cilës mund të lindin konflikte të shumta), *ballgur* (miell misri i bluar trashë që përdoret për ushqim kafshësh), *japâ°:nxh* (veshje barinjsh në formën e palltos, e prodhuar nga leshi i deleve), *pázêm* (grumbull penjsh), *kukêl* (gjendje e rëndë, krizë) etj.

## Literatura dhe përfundimet

Ky studim monografik kompletohet me bibliografinë mjaft të pasur dhe të gjerë, të ndarë sipas fushave të studimit nga autorë të vendit dhe të huaj.

Në studim janë përdorur të gjitha shkurtesat dhe shenjat fonetike të nevojshme për t'i lexuar tekstet dialektore që janë të veçanta për këtë të folme. Autori jep përfundime të qëlluara për të gjitha tezat e ngritura në fillim, duke dëshmuar për pjekurinë e analizimit dhe përfundimit të një studimi. Përfundimi është i përkthyer në gjuhën angleze.

## Përfundime

Siç mund të shihet edhe prej kësaj strukture, studimi i Dr. Sejdi Gashit hapet si kërkim antropogjeografik, një traditë kjo e pranishme pothuajse gjatë gjithë shekullit XX, vazhdon me identifikimin e dukurive fonetike përmes komunikimit të drejtpërdrejtë në terren, duke përdorur edhe përshkrimin e saktë përmes shenjave diakritike, pastaj sjell një sintezë të analizës morfologjike dhe sintaksore dhe përmbillet me një numër tekstesh popullore e një fjalorth dialektor, me të cilin e bën të mundur jo vetëm leximin e teksteve me interes për intonacionin dhe kuptimet morfo-sintaksore, por edhe mundëson njohjen e gjithë korpusit leksikor të kësaj treve.

Autori përdor disa metoda, me mjaft sukses, siç janë: metoda e analizës teorike, metoda e analizës së dokumentacionit, metoda përshkruese, metoda krahasuese dhe metoda statistikore. Nga rezultatet, ai dëshmon se i njeh metodat, duke filluar nga përzgjedhja e pyetësorëve, analiza teorike e tyre, krahasimi i rezultateve, përshkrimi i tyre dhe dhënia e statistikave nëpërmjet dhjetëra tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.

Autori ka shfrytëzuar literaturë të nevojshme dhe, me titujt e shfrytëzuar, ka dëshmuar se ka njohuri për problemin që ka ngritur. Citimet i ka përdorur sipas stilit APA. Studiuesi Gashi në këtë punim ka dëshmuar se është mjaft i përgatitur në aspektin teorik për termat kyç të punës së tij hulumtuese, siç janë: vjelja e materialit në terren, analiza teorike gjuhësore e të folmes së Istogut etj.

Duke e përfunduar recensën, mund të arrij në përfundimin se studimi monografik “Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë”, i studiuesit Sejdi Gashi, me origjinalitetin e tij, me të dhënat e shumta teorike, me disa veçori të përbashkëta midis të folmeve tjera të gegërishtes, me materialin e pasur dialektologjik, me leksikun e pasur dhe me vështrimet fonetike, morfologjike dhe sintaksore të së folmes së Istogut me rrethinë, paraqet një kontribut të çmuar në fushën e studimeve të dialektologjisë shqiptare, e cila hap shtigje të reja për studime teorike, në këtë fushë të gjuhësisë shqiptare dhe studimeve dialektore në përgjithësi. Në këtë mënyrë, autori Sejdi Gashi me këtë vepër të rëndësishme shkencore, e pasuron dialektologjinë dhe gjuhësinë tonë në përgjithësi.